

VENDIM
Nr. 47, datë 4.8.2006

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË MARRËVESHJES PËR
SHËRBIMIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OST SHA
DHE KESH SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, pikës 2 (Lidhjet mes pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike), të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.539, datë 12.08.2004 “Modeli Tranzitor i Tregut të Energjisë Elektrike”; nenit 11 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.05.2004, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.05.2005 “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 10, germa c, të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.1, datë 22.01.2005 “Rregullat e tregut të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.08.2006, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e marrëveshjes për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të draftmarrëveshjes ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a. për “Shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike”.
 2. Shqyrtimin dhe paraqitjen për miratim të draftmarrëveshjes (rishikuar) ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a. nga departamentet dhe Këshilltari i Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
 3. Organizimin e seancave dëgjimore nga ERE, me palët pjesëmarrëse për çështjet e trajtuara me variante të ndryshme në këtë marrëveshje, si dhe të tjera që mund të konstatohen gjatë shqyrtimit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta